

TERMAT E REFERENCËS

Qëndresa Qytetare, që më poshtë referohet si “Partneri i Bashkëpunimit”, dëshiron të kontraktojë shërbimet e një kompanie auditimi me qëllim auditimin vjetor të jashtëm të organizatës, siç përcaktohet në marrëveshjen ndërmjet partnerit të bashkëpunimit dhe kompanisë audituese. Fondi total i organizates është 2800 EURO.

Auditimi do të kryhet në përputhje me standardet kombëtare të auditimit sipas SKK për organizatat.

OBJEKTIVAT DHE OBJEKTI I AUDITIMIT

Objektivi është auditimi vjetor të jashtëm të organizatës për periudhën [01/01/2023 në 31/12/2023] për të shprehur një opinion auditimi sipas SKK, nëse pasqyrat financiare janë në përputhje me dokumentet e kontabilitetit të formati i dorëzimit të bilancit për organizatat sipas Drejtorisë së Tatimeve.

Raportet e Auditimit do të lëshohen në gjuhën Shqiptare dhe Angleze.

DETYRA SHITESË; TË RISHIKOHEN FUSHAT E MËPOSHTME NË PËRPUTHJE ME TERMAT E REFERENCËS SI MË POSHTË:

Procedurat e detyrueshme që do të përfshihen:

1. Të vëzhgohet nëse pasqyrat financiare janë të strukturuar në atë mënyrë të atillë që të bëjë të mundur krahasimin e drejtpërdrejtë me buxhetin⁴ e fundit të miratuar.

2. Të vëzhgohet dhe inspektohet nëse pasqyrat financiare ofrojnë informacion në lidhje me:

- Rezultatit financiar me zërin në buxhet (si të ardhurat ashtu edhe kostot) për periudhën raportuese dhe kolonat për informacionin kumulativ në lidhje me periudhat e mëparshme sipas marrëveshjes aktuale.
- Kur është e mundur, krahasoni nëse bilanci i fondit të hapjes për periudhën raportuese përputhet me atë që është deklaruar si bilanc i fondit të mbylljes në periudhën e mëparshme raportuese.
- Evidentimin e fitimeve/humbjeve nga kursi i këmbimit. Kontrolloni dhe konfirmoni nëse raporti përfshin të gjithë zinxhirin e këmbimit të monedhës që nga disbursimi i fondeve nga donatori deri tek përdorimi nga projekti brenda në organizatë në monedhën vendase, nëse ka.
- Shënime shpjeguese
- Shuma e fondeve që iu është kaluar partnerëve zbatues, nëse ka.

3. Të kontrollohet dhe inspektohet se sa shpesh i faturohen projektit kostot e pagave gjatë periudhës raportuese.

Zgjidhni një kampion prej tre individësh për tre muaj të ndryshëm dhe:

a) Kërkohe dhe kontrollohet nëse kostot e pagave të faturuara shoqërohen me dokumentacion mbështetës.

b) Kërkohe dhe inspektohet nëse ditët e punës të faturuara dokumentohen dhe verifikohen nga një menaxher. Shqyrtoni dhe kontrolloni se sa shpesh janë bërë rakordimet mes ditëve të punës të faturura dhe ditëve faktike të punës të realizuara.

c) Inspektohet nëse partneri i bashkëpunimit respekton legjislacionin tatimor në fuqi në lidhje me tatimet mbi të ardhurat personale (TAP) dhe pagesat e sigurimeve shoqërore.

4. Të inspektohet dhe konfirmohet që gjendja e fondit (sipas raportit financiar) në fund të vitit financiar, nëse është e njëjtë me atë që jepet në informacionin në sistemin e kontabilitetit dhe/ose llogarinë bankare.

RAPORTIMI

Raportimi do të nënshkruhet nga audituesi përgjegjës (jo vetëm kompani e auditimit) dhe do të përfshijë titullin e audituesit përgjegjës.

Raportimi nga audituesit do të përfshijë një raport të audituesit të pavarur në përputhje me formatin e standardit SKK për organizatat dhe opinionin e audituesit do të shprehet qartë. Raportit të auditimit i bashkëngjitet raporti financiar që ka qenë objekt i auditimit.

Raportimi do të përfshijë edhe një Letër për Drejtuesit, ku jepet një përmbledhje e të gjitha gjetjeve nga auditimi, së bashku me dobësitë e identifikuar gjatë procesit të auditimit. Audituesi do të japë rekomandime për të trajtuar gjetjet dhe dobësitë e identifikuar. Rekomandimet do të prezantohen sipas rëndësisë dhe me një klasifikim rreziku.

Në Letrën për Drejtuesit do të paraqiten edhe masat e marra nga partneri i bashkëpunimit për të trajtuar dobësitë e identifikuar në auditimet e mëparshme. Nëse auditimi i mëparshëm nuk ka pasur ndonjë gjetje apo dobësi për t'u trajtuar, në raportimin e auditimit do të jepet një sqarim i tillë.

Nëse audituesi vlerëson se nuk janë identifikuar gjetje ose dobësi gjatë auditimit që do të sillnin si rezultat një Letër për Drejtuesit, në raportimin e auditimit do të jepet një shpjegim i këtij vlerësimi.